



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 28.03.2013
Nr. 0204-315

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS, Nr.02/06-4144/16, Pranuar me datë, 13.03.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.02/06-4144/16, të miratuar me datë 28.02.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.02/06-4144/16, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Mitrovicës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL.-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL.-së
Arkivit të MAPL.-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 28.03.2013

Br. 0204-315

Za: Avni Kastrati, Gradonačelnik Opštine Mitrovica
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine Opštine Mitrovica

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE MITROVICA, br.02/06-4144/16, Priljeno dana, 13.03.2013.

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmatranja Odluke br.02/06-4144/16, usvojene dana 28.02.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt navadene u nastavku,ima puni pravni efekat .

- Odluka Br.02/06-4144/16 za formiranje Komisije za imenovanje ulica i drugih javnih mesta u Opštini Mitrovica

S poštovanjem,


Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



13.03/13

0204-315

KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06-4144/16 dt. 28.02.2012
Mitrovicë

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 17 pika o dhe nenin 40 paragrafi 2 pika i të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale; nenin 10 paragrafi 1 pika m, nenin 23 dhe nenin 28 paragrafi 1 pika j të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 28.02.2013 pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Mitrovicës; me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02/06 – 2834/9 dt. 14.02.2013); sjell këtë:


VENDIM

Për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Mitrovicës

1. Me këtë vendim **FORMOHET** Komisioni për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Mitrovicës.
2. Komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - 1) Valbonë Fazliu Beqiri
 - 2) Murteza Berisha
 - 3) Ibrahim Bala
 - 4) Një anëtar nga DPU
 - 5) Një anëtar nga Shoqëria Civile
 - 6) Dy anëtarë nga komuniteti i intelektualëve
 - 7) Një përfaqësues nga komunitetet tjera
 - 8) Një përfaqësues nga këshillat e fshatrave.
3. Anëtarët e Komisionit të paraparë të pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 caktohen nga Kryetari i Komunës.
4. Komisioni në mbledhjen e parë zgjedh Kryetarin e Komisionit.
5. Detyrë e Komisionit është që t'i propozojë Kuvendit propozim-vendimin për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Mitrovicës.
6. Komisioni është i obliguar të punojë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit.
8. Anëtarët e Komisionit për punën e tyre në komision do të kompensohen nga buxheti i Kryetarit të Komunës.
9. Për shumën dhe formën e kompensimit vendosë Kryetari i Komunës me vendim të veçantë.
10. Komisioni për punën e vet do t'i raportojë drejtpërdrejt Kuvendit të Komunës.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Dr. Rrustem MUSA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive